

Rruga "Dora D'istria", Nr.10,
P.O. Box 8363, Tiranë,
+355 4 22 28 260

www.amf.gov.al



Sigurimi i Detyrueshëm i mjetit motorik në sektorin e transportit




AMF 202378892-895
AMF 2043254-8732-
218292-57843294212
42714-3873245254-2
9-4
4.5
AMF 2043254-8732-
-57843294212
-3873294212
AMF 2043254-8732-
42714-3873245254-2
218292-57843294212
42714-3873245254-2
3873294212-895
AMF 92-578492-895
33515431233-21233

amf

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Përmbajtja:

1. Çfarë kuptojmë me sigurimin e detyrueshëm të mjetit motorik në sektorin e transportit?
2. Subjektet e kontratës së sigurimit (policës) të detyrueshëm të mjetit motorik në sektorin e transportit
3. Vlefshmëria e kontratës së sigurimit
4. Ku mund të siguroheni ?
5. Cilat janë shoqëritë e sigurimit të cilëve mund t'ju drejtohesh?
6. Ndërmjetësit në sigurime të cilëve mund t'ju drejtohesh
7. Detyrime të pronarit/drejtuesit të mjetit motorik
8. Detyrime të shoqërisë së sigurimit
9. Detyrimi për informim
- 10.Format e përmbushjes së detyrimit për informim
- 11.Sigurimi i detyrueshëm motorik për mjetet me rregjistrim të huaj
- 12.Tarifat e primit dhe pagesa e primit te sigurimit
- 13.Si veprohet për të paraqitur kërkesën për dëmshpërblim në rast aksidenti?
- 14.Çfarë është kufiri i mbulimit
- 15.Si mund të bëni një ankesë



Sigurimi detyrueshëm i mjetit motorik në sektorin e transportit

- Ky material informues ka për qëllim t'i shërbejë konsumatorit si një udhëzues, për t'i ndihmuar të kenë më tepër informacion përpara se të vendosin për të marrë një kontratë sigurimi të detyrueshëm për mjetin motorik. Materiali jep informacion edhe mbi të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit.

Çfarë kuptojmë me sigurimin e detyrueshëm të mjetit motorik në sektorin e transportit?

- Sigurimi i detyrueshëm i mjetit motorik në sektorin e transportit është sigurimi i përgjegjesisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti në vijim i referohemi “Sigurimi i detyrueshëm i mjetit motorik”.
- Sigurimi i detyrueshëm i mjetit motorik është një sigurim i detyrueshëm për të gjithë pronarët e mjeteve motorike.



Subjektet e kontratës së sigurimit (policës) të detyrueshëm të mjetit motorik në sektorin e transportit.

Palët e përfshira në këtë kontratë sigurimi janë:

I siguruari është personi (juridik apo fizik) interesi pasuror i të cilit është siguruar. Detyrimin për të lidhur kontratën e sigurimit të detyrueshëm të mjetit motorik në sektorin e transportit e ka pronari i mjetit.

- Në rastet kur mjeti motorik përdoret/drejtohet nga persona të tjerë të ndryshëm nga pronari i mjetit, polica e sigurimit mbulon edhe dëmet e shkaktuara nga përdorimi i mjetit prej personave të tjerë, kur këta e përdorin mjetin me miratimin e pronarit.

Siguruesi është shoqëria e sigurimit, me të cilën pronari i mjetit motorik ka lidhur kontratë për sigurimin e përgjegjesisë për dëme shkaktuar palëve të treta. Kjo shoqëri sigurimi nëpërmjet nënshkrimit të policës së sigurimit merr përsipër pagesën e dëmshpërblimit për dëmet që iu shkaktohen palëve të treta nga pronari, përdoruesi apo drejtuesi i mjetit motorik me të cilin ka nënshkruar kontratën e sigurimit.

Përfituesi: *Pala e dëmtuar* është çdo person që ka pësuar një dëm si pasojë e një aksidenti të shkaktuar nga një mjet motorik, i cili ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim, për humbjet apo dëmtimet e pësuar, të shkaktuara nga mjeti i motorik.

- ❖ *Nuk konsiderohet palë e dëmtuar dhe nuk gëzon të drejtën e dëmshpërblimit drejtuesi i mjetit shkaktar të aksidentit si dhe pronari i këtij mjeti motorik në rastet kur ky është shkaktar i aksidenti.*



Vlefshmëria e kontratës së sigurimit

- Si rregull kontrata e sigurimit të detyrueshëm lidhet për një afat 1 vjeçar dhe duhet të rinovohet çdo vit për aq kohë sa mjeti është në qarkullim.
- Vlefshmëria e kontratës së sigurimit të detyrueshëm motorik, fillon nga përfundimi i orës 24:00 të ditës së përcaktuar në dokumentin e sigurimit si datë e fillimit të mbulimit dhe përfundon me mbarimin e orës 24:00 të ditës së përcaktuar si datë e përfundimit të mbulimit, kur nuk është përcaktuar ndryshe në kontratën e sigurimit.

Kur konsiderohet e lidhur kontrata e sigurimit të sigurimit të detyrueshëm motorik?

Kontrata e sigurimit të detyrueshëm motorik konsiderohet e lidhur dhe prodhon efektet e saj, kur është:

- Nënshkruar polica e sigurimit nga të dy palët, dhe
- Paguar primi apo kësti i parë i tij.

Kujdesuni të merrni një **kopje origjinale** të policës dhe verifikoni që dokumenti nuk përmban korrigjime.

**Polica e sigurimit është dokumenti që vërteton që ju keni një sigurim të vlefshëm të përgjegjësive së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik për dëmet shkaktuar palëve të tretë nga përdorimi i këtij mjeti.*




Ku mund të siguroheni ?

Kontrata e sigurimit të detyrueshëm motorik mund të lidhet direkt me shoqërinë e sigurimit të Jo-Jetës, ose përmes ndërmjetësve në sigurime, të licencuar/miratuar nga AMF dhe të regjistruar në Regjistrin e Ndërmjetësve në Sigurime.

Në secilin rast, kontrata e sigurimit lidhet me vetë shoqërinë e sigurimit dhe jo me ndërmjetësit në sigurime. Nëse një agjent apo broker në sigurime kontakton me konsumatorët dhe propozon një takim për të prezantuar një produkt sigurimi të Jo-Jetës, konsumatorët duhet të jenë të përgatitur për këtë takim dhe të mendojnë se çfarë kanë nevojë të sigurojnë. Përpara se agjenti apo brokeri të prezantojë produktin bëni verifikime mbi:

- Emrin, mbiemrin dhe adresën e ushtrimit të veprimtarisë;
- Licencën/Vërtetimin për të ofruar këto lloj shërbimesh dhe;
- Shoqërinë e sigurimit për të cilën punon.



Cilat janë shoqëritë e sigurimit të cilëve mund t'u drejtohesh?


Kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik ofrohen vetëm nga shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës, të cilët janë persona juridikë të licencuar dhe mbikëqyrur nga AMF për të ushtruar veprimtari sigurimi të Jo-Jetës. Lista me shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës, të cilat ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, gjendet në faqen zyrtare të internetit të AMF-së:

https://amf.gov.al/ts_shoqeri_sigurimi.asp.

Para nënshkrimit të një kontrate sigurimi të Jo-Jetës gjithmonë verifikoni që emri i shoqërisë së sigurimit të Jo-Jetës i përgjigjet saktësisht njëres prej atyre që janë të listuara në faqen e internetit të AMF-së

Cilët janë ndërmjetësit në sigurime të cilëve mund t'u drejtohesh?

- Ndërmjetësit në sigurime, të cilëve mund t'u drejtohesh, janë agjentët apo shoqëritë e agjentëve dhe brokerat apo shoqëritë e brokerimit.
- Veprimtaria e agjentit në sigurime kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore mbi kontratën e sigurimit, si dhe nënshkrimin e saj nga i siguruari.



- Veprimtaria e brokerimit në sigurime përfshin të gjitha ato veprimtari si prezantimi, propozimi, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, duke identifikuar ofertën më të mirë të sigurimit në treg për konsumatorin, duke e paralajmëruar për mangësitë apo avantazhet e produktit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të konsumatorit. Nëse është e nevojshme, brokeri propozon ndryshime në kontratën e sigurimit, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit.

Në faqen zyrtare online www.amf.gov.al gjendet e publikuar listën e ndërmjetësve të licencuar/autorizuar për të kryer shërbime ndërmjetësimi.

Detyrime të pronarit/ drejtuesit të mjetit motorik



- Pronari I çdo mjeti motorik,përpara përdorimit të mjetit,është I detyruar të lidhë një kontratë sigurimi të përgjegjësishë së pronarit për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi I këtij mjeti,si dhe duhet të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim. Kjo kontratë sigurimi ofrohet nga të gjitha shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës të licencuara në Republikën e Shqipërisë.
- Në rast se ndryshon pronësia e mjetit gjatë periudhës së sigurimit,të drejtat dhe përgjegjësitë,që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, i kalojnë pronarit të ri dhe vlejné deri në përfundimin e kontratës së sigurimit.
- Pronari i ri, brenda **tetë ditëve**,detyrohet të njoftojë shoqërinë e sigurimit për ndryshimin e pronësisë së mjetit dhe pasqyrimin e këtij ndryshimi në kontratën e sigurimit.



Kujdes!

Drejtuesi i mjetit motorik është i detyruar që:

- Gjatë përdorimit të mjetit të mbajë gjithmonë me vete policën e sigurimit, si dhe ta paraqesë atë sa herë i kërkohet nga personi zyrtar i autorizuar.
- Në rast aksidenti,të japë të dhënat personale dhe të dhënat që lidhen me sigurimin e detyrueshëm,tek të gjithë personat e përfshirë në aksident,të cilëve mund t'u lindë e drejta të kërkojnë dëmshpërblim.
- Të drejtojë mjetin në përputhje me rregullat e qarkullimit rrugor.

Detyrime të shoqërisë së sigurimit



Shoqëria e sigurimit është e detyruar:

- Të lidhë kontratën e sigurimit të detyrueshëm, në përputhje me parashikimet e Ligjit, me kushtet e sigurimit dhe tabelën e primeve të sigurimit të caktuara e të publikuara paraprakisht prej saj. Shoqëria e sigurimit nuk mund të refuzojë kërkesën për të lidhur kontratën e sigurimit, kur aplikuesi pranon kushtet, sipas të cilave shoqëria e zbaton këtë sigurim. Në rast të refuzimit të mundshëm të shoqërisë së sigurimit për të lidhur kontratën e sigurimit, njoftoni menjëherë AMF-në. Autoriteti do të kryejë verifikime të mëtejshme dhe do ndërmarrë masat e duhura mbikëqyrëse.
- Të publikojë primet e rrezikut, si dhe primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit në faqen e saj të internetit dhe t'i mbajë ato të afishuara në faqe gjatë gjithë periudhës së zbatimit;
- Të trajtojë çdo kërkesë për dëmshpërblim, si dhe të kryejë pagesën brenda afatit ligjor.
- Të ushtrojë veprimtarinë e saj me profesionalizëm, dhe përkushtim ndaj të siguruarve.
- Të veprojë me mirëbesim dhe ndershmëri për respektimin e të drejtave të të siguruarve.
- Të informojë të siguruarin për kushtet e përgjithshme e të veçanta të kontratës së sigurimit, përfitimet që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, tarifatat dhe primet që i siguruari duhet të paguajë.

Detyrimi për informim



Shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit në sigurime detyrohen t'ju japin me shkrim përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit të detyrueshëm motorik, të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me sigurimin. Ky informacion përmban:

- Të dhëna rreth shoqërisë së sigurimit të tilla si: emri dhe adresa e shoqërisë; adresa e degës, apo ndërmjetësit nëpërmjet të cilit po bëhet nënshkrimi i kontratës së sigurimit;
- Rreziqet e mbuluara dhe të përjashtuara;
- Afatet e fillimit dhe mbarimit të kontratës së sigurimit;
- Mënyrat e ndryshimit dhe përfundimit të kontratës;
- Metodën e llogaritjes të primit, afatet dhe mënyrat e pagesës së tij, pasojat e mospagesës së primit, si dhe pjesën e primit që i korrespondon mbulimit bazë dhe shtesë;
- Procedurat e brendshme të trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, si dhe strukturën përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- Kërkesat dhe afatet për pagesën e dëmshpërblimit;
- Procedurat jashtëgjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve, në lidhje me kontratën e sigurimit, në përputhje me rregullat e brendshme të siguruesit pa ndikuar në të drejtën e ankimit në gjykatë;
- Të dhëna të përgjithshme për taksat/tatimet dhe komisionet në lidhje me kontratën e sigurimit.

Kuadri ligjor parashikon mundësinë që informacioni parakontraktual të jepet edhe verbalisht apo nëpërmjet telefonit ose shërbimit të qendrës së komunikimit, por biseda telefonike duhet të regjistrohet.

Format e përmbushjes së detyrimit për informim

- Çdo shoqëri sigurimi detyrohet të informojë të sigurveçarit nëpërmjet faqes zyrtare të internetit dhe /ose me shkrim, lidhur me sigurimin e ofruar, mbulimin dhe çështje të tjera.
- Informacioni duhet të jetë:
 - I plotë
 - I saktë
 - I qartë
 - Lehtësisht i aksesueshëm
- Konsultoni faqet *online* të shoqërive të sigurimit të cilat ofrojnë sigurimin e detyrueshëm motorik apo pyesni punonjësin e shoqërisë ose ndërmjetësin për të marrë informacionin që ju nevojitet

Sigurimi i detyrueshëm motorik për mjetet me rregjistrim të huaj

Në varësi të territorit të përdorimit të mjetit motorik, Ju mund të dispononi një ose disa nga policat e sigurimit të detyrueshëm.



- Polica e sigurimit të përgjegjësisë ndaj palëve të treta (TPL) për mbulimin e dëmeve materiale dhe shëndetësore që mund t'u shkaktohen palëve të treta, si rezultat i përdorimit të mjetit motorik në Republikën e Shqipërisë.

- Mjeti motorik me regjistrim të huaj, që hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të jetë i paisur me dokument ndërkombëtar të sigurimit të mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta (Karton Jeshil), të vlefshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky sigurim ofrohet nga shoqëritë e sigurimit të vendit ku është i rregjistruar mjeti motorik.



- Mjeti motorik me regjistrim të huaj, që hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëse nuk disponon një dokument ndërkombëtar të vlefshëm të sigurimit të përgjegjësisë ndaj palëve të treta (karton jeshil), atëherë ai është i detyruar të lidhë kontratë për sigurimin e përgjegjësisë nga përdorimi i mjetit motorik (Sigurim Kufitar), të vlefshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, me periudhë vlefshmërie, që mbulon periudhën e qëndrimit të tij, por jo më pak se 15 ditë. Në çdo pikë të kalimit të kufirit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë gjenden agentë të shoqërive të sigurimit pranë të cilave mund të pajiseni me policën kufitare



Ky rregull, zbatohet sipas te njëjtit parim, edhe ne rastet kur mjeti motorik me regjistrim në Republikën e Shqipërisë kalon në territorin e një shteti tjetër.

Tarifat e primit

- Shoqëria e sigurimit përcakton vetë tarifat e primit të sigurimit, sipas kushteve të tregut, dhe fillon t'i zbatojë ato, pasi njofton zyrtarisht AMF.
- Autoriteti miraton rregullat për përcaktimin e kushteve të përgjithshme të sigurimit të detyrueshëm dhe nivelin e rezervave teknike dhe provigjoneve.



Pagesa e primit

Pagesa e primit mund të kryhet në disa forma në varësi të kontratës së sigurimit:



- Me këste
- Për të gjithë periudhën

Pagesa e primit mund të kryhet nëpërmjet sistemit bankar dhe/ose para në dorë.

Si dëshmi e pagesës së primit mund të jetë, dokumenti bankar i pagesës apo mandati i arkëtimit i lëshuar nga shoqëria e sigurimit me përshkrimin e pagesës së kryer.

Si veprohet për të paraqitur kërkesën për dëmshpërblim në rast aksidenti?

Nëse keni pësuar dëm nga një aksident automobilistik dhe nuk keni qenë shkaktari i aksidentit Ju lind e drejta të dëmshpërbleheni për dëmin pasuror dhe/ose jopasuror të pësuar. Për të përfituar dëmshpërblimin duhet të depozitoni kërkesën për dëmshpërblim dhe dokumentacionin shoqërues.

- **Pala e dëmtuar, ka të drejtë të depozitojë kërkesën për dëmshpërblim:**
- **Te siguruesi (shoqëria e sigurimit), ku ka qenë i siguruar pronari i mjetit shkaktar të aksidentit.**

Në rast se aksidenti është shkaktuar nga një mjet motorik i pasiguruar, i paidentifikuar apo nga një mjet me regjistrim të huaj dhe me dokument të siguracionit ndërkombëtar, kërkesa për dëmshpërblim depozitohet pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimeve.

Kërkesa për dëmshpërblim mund të paraqitet brenda dy vjetësh nga momenti i aksidentit. Megjithatë rekomandojmë që të njoftoni shoqërinë e sigurimit përgjegjëse sapo të keni mundësi dhe të paraqisni kërkesën për dëmshpërblim.

Gjithashtu Ju keni të drejtë të kontaktoni me shoqërinë e sigurimit apo ndërmjetësin në sigurime që Ju ka ofruar kontratën e sigurimit dhe të merrni udhëzimet e informacionin që ju nevojitet.

Kërkesa për dëmshpërblim duhet të shoqërohet me dokumentacionin e nevojshëm për trajtimin e saj. Për të marrë informacion mbi listën e dokumentacionit të nevojshëm konsultoni link:

[Http://amf.Gov.AL/pdf/ligje/rregullorenr_53_20180404_pdf\(autosaved\).Pd](http://amf.Gov.AL/pdf/ligje/rregullorenr_53_20180404_pdf(autosaved).Pd)

Çfarë është kufiri i mbulimit?



Kufiri i mbulimit ose limiti i përgjegjësisë është shuma maksimale që shoqëria e sigurimit është e detyruar të paguajë për të dëmshpërblyer palën/palët e dëmtuara për dëmin e shkaktuar nga një aksident ose seri aksidentesh të ardhura nga një ngjarje sigurimi.

Në rast se vlera totale e dëmtimit për një ose disa palë të dëmtuara nga një ngjarje, tejkalon kufirin e mbulimit të drejtat e palës/palëveve të dëmtuara, ndaj shoqërisë së sigurimit zvogëlohen në mënyrë përpjestimore.



Kufiri i mbulimit përcaktohet në nenin 26 të Ligji Nr. 10076 datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.


Si mund të bëni një ankesë

Nëse keni pakënaqësi apo mendoni që shoqëria e sigurimit nuk i përmbahet kushteve të kontratës, ju mund të bëni një ankesë.

Për të marrë më tepër informacion jeni të lutur të konsultoheni me Materialin Informues për Ankesat të publikuar nga Autoriteti i cili gjendet në www.amf.gov.al

Legjislacioni i zbatueshëm

Sigurimi i detyrueshëm në sektorin e transporti rregullohet nga Ligji Nr. 10076 datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe Rregullore e Autoritetit Nr. 53 datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”.



Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe Rregullorja Nr. 36, datë 28 maj 2015, ka përcaktuar rregullat sipas të cilave shoqëritë e sigurimit përmbushin detyrimin për informimin e të siguarve apo personave të tjerë të interesuar.